

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6542  
E mërkurë, 23 shkurt 2022  
çmimi 0.40 €

## Krijimi, shkrimi dhe përpjekja për rishkrim të historisë së Kosovës!

FAQE 6-7



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ËSHTË MBAJTUR SEANCA E RADHËS NË LIDHJE ME PROCESIN GJYQËSOR KUNDËR ISH-DREJTUESVE TË UÇK-SË NË HAGË

## MBROJTJA: ZPS-ja PO DËSHIRON TA PËRJASHTOJË MBROJTJEN PËR INTERVISTIMIN E DËSHMITARËVE

FAQE 3

### OPINION

**QËNDRIMI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR GJATË VITEVE 1998-1999** F. 8

Prof. dr. Sabit SYLA



### AKTUALE



**GËRVALLA PRANON SE KOSOVA KA NGEÇUR NË PROCESIN E NJOHJEVE TË REJA** F. 3

**KRASNIQI, AMBASADORIT AMERIKAN: PDK-JA DO TË JAPË KONTRIBUT PËR TEMAT NACIONALE** F. 5

**RAPORTET E KOSOVËS ME VATIKANIN MUND TË THELLOHEN EDHE MË TEJ** F. 2

### EKONOMI



**"SUBVENCIONET I", AKTAKUZË KUNDËR 21 PERSONAVE** F. 6

### SPORT

**DRITA SYNON T'U RIKTHEHET FITOREVE NDAJ MALISHEVËS** F. 10



Avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, gjatë procesit gjyqësor, ka thënë se mbrojtjes duhet t'i lejohej qasje pa kufizime për intervistimin e dëshmitarëve. Ai ka thënë se në situatën aktuale dhe me masat mbrojtëse të propozuara nga prokuroria, nuk ka barazi në mes të palëve në procedurë. Edhe avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka hedhur akuza të ashpra ndaj Prokurorisë së Speciales në lidhje me protokollin e propozuar nga ajo për kontaktet me dëshmitarët

## Kuvendi miraton tri marrëveshje ndërkombëtare

FAQE 3



## KOSOVA PËRKRAH UKRAINËS KUNDËR AGRESIONIT TË RUSISË

FAQE 4-5

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



ËSHTË MBAJTUR SEANCA E RADHËS NË LIDHJE ME PROCESIN GJYQËSOR KUNDËR ISH-DREJTUESVE TË UÇK-SË NË HAGË

## Mbrojtja: ZPS-ja po dëshiron ta përjashtojë mbrojtjen për intervistimin e dëshmitarëve



Avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, gjatë procesit gjyqësor ka thënë se mbrojtjes duhet t'i lejohet qasje pa kufizime për intervistimin e dëshmitarëve. Ai ka thënë se në situatën aktuale dhe me masat mbrojtëse të propozuara nga prokuroria, nuk ka barazi në mes të palëve në procedurë. Edhe avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka hedhur akuza të ashpra ndaj Prokurorisë së Speciales në lidhje me protokollin e propozuar nga ajo për kontaktet me dëshmitarët

**HAGË, 22 SHKURT (ER)** - Në Gjykatën Speciale në Hagë është mbajtur të martën seanca e radhës në lidhje me procesin gjyqësor kundër ish-drejtuesve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Në këtë seancë është diskutuar në lidhje me intervistimin e dëshmitarëve në rastin e Thaçit dhe të tjerëve.

Avokati i Thaçit, Gregory Keohe, ka thënë se mbrojtjes duhet t'i lejohet qasje pa kufizime për intervistimin e dëshmitarëve. Ai ka thënë se në situatën aktuale dhe me masat mbrojtëse të propozuara nga prokuroria, nuk ka barazi në mes të palëve në procedurë. "Nuk ka barazi të palëve. Flasin për një gjykatë që është e Kosovës dhe dispozitat që duhet të ndiqen. Kjo është shumë e qartë në kuadrin e kësaj gjykate. Procesi gjyqësor kërkon që mbrojtja të

përfshihet në të gjithë gamën e shërbimeve. Pra, mbrojtja duhet të sigurojë pa kufizime mbrojtjen e një personi, mbrojtjen e provave dhe përgatitjen për marrjen në pyetje. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut thotë se marrja në pyetje duhet të bëhet pa kufizime, ndërsa ndryshe vepron Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS)", ka thënë Keohe.

Më tutje, ai ka thënë se 157 dëshmitarë të ZPS-së kanë masa mbrojtëse. "Dëshmitarët në listën e dëshmitarëve nuk janë dëshmitarë në listën e ZPS-së. Pikë. Janë dëshmitarë që duhen marrë në pyetje nga të gjitha palët. Kjo është një shtesë paligjshmërie. Kemi 326 dëshmitarë, pothuajse 50 për qind kanë masa mbrojtëse. Pra 157 dëshmitarë nga 326 kanë masa të tilla", ka thënë ai.

Avokati i Thaçit ka thënë se absurditeti qëndron se ZPS-ja

ka kërkuar masa mbrojtëse edhe për zyrtarë qeveritarë, ndërkombëtarë, si dhe për oficerë ushtarakë. "Janë nën masat mbrojtëse të ZPS-së. Kam lexuar dëshminë e një dëshmitari që përfaqësohej nga një avokat i zoti në Britani. Pra, nga të gjithë këta persona, ZPS-ja po dëshiron ta përjashtojë mbrojtjen që ta bëjë intervistimin e tyre. ZPS-ja thotë se kërkon që ta shmangë ritraumatizimin e viktimave. A po e thotë me seriozitet ZPS-ja se edhe gjeneralëve duhet t'u mbrojtje anën psikologjike? Sigurisht që jo", ka thënë avokati i Thaçit.

**Avokati i Veselit: E tmerrshme, Prokuroria orkestron takim me ambasadorët e BE-së për të akuzuarit**

Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka hedhur akuza

përse përfshihen dëshmitarët në këtë protokoll. "Nuk ka asnjë arsye të besoj se mbrojtja t'i korruptojë ata. Është për të qeshur, fyese dhe nuk duhet marrë seriozisht. E kundërta është e vërtetë. Për ndërkombëtarët që do të thirren si dëshmitarë, ky sistem nuk duhet të zbatohet. Pra minimum duhet të përjashtohet çdo person që nuk është viktimë. Gjithçka që mund të bëhet për ta bërë numrin e menaxhueshëm, ndryshe do të kemi vonesë për dy vjet", ka deklaruar Emmerson, duke theksuar se është një proces ku secila palë duhet të ketë besim që ta paraqesë çështjen e vet. "Nëse Prokuroria thotë se nuk mund t'ia kesh besën mbrojtjes, kjo është për të qeshur. Kam frikën se gjithçka mund të rrëzohet sepse gjithçka bazohet në besimin mes palëve. Këto janë kërcënime për bashkëpunimin e dëshmitarëve", është shprehur ai.

Avokati i Veselit ka thënë se Prokuroria ka orkestruar takim me ambasadorët evropianë për çështjen e të akuzuarve dhe, sipas tij, kjo është diçka shokuese. Sipas tij, këto janë zhvillime të tmerrshme. "Sipas tyre, ne nuk duhet ta kemi besën dhe ne jemi njerëz jo të duhur. Çështjet e ngritura nga mbrojtja kundër Prokurorisë lidhen me deklaratat jo të saktë lidhur me kohëzgjatjen e procedurave për periudhën paraprake dhe shanset e lirimimit paraprak. Prokuroria e ka keqorientuar gjykatën në shumë mënyra. Prokuroria ka orkestruar takimin e ambasadorëve evropianë në lidhje me të akuzuarit. Kemi pasur zhvillime të tmerrshme sa i përket sjelljes së Prokurorisë. Është një shok dhe tronditje se si Prokuroria është lejuar të silllet. Të thuash se unë jam një person që do të kryej krim në përgatitjen e mbrojtjes është e turpshme. Prokuroria ka humbur çdo arsye dhe logjikë dhe është e dëshpëruar", ka thënë Emmerson.



# Gërvalla pranon se Kosova ka ngecur në procesin e njohjeve të reja

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, u është përgjigjur akuzave të opozitës për mungesë të njohjeve të reja, duke pranuar se ka ngecje në procesin e njohjes së shtetësisë së Kosovës por që, sipas saj, kjo është një ngecje e vazhdueshme nga vitet e kaluara

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 SHKURT - Dy partitë opozitare në vend, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kanë kërkuar sqarime nga ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës në lidhje me procesin e njohjeve të reja.

Deputetja e AAK-së, Time Kadrijaj, në seancën e së martës të Kuvendit, e ka pyetur ministren Gërvalla nëse do të ketë më njohje të reja pas asaj të Izraelit. “Është bërë një vit që Kosova ka arritur njohjen me Izraelin. Sa keni punuar në këtë drejtim, a pritët të kemi njohje të re? Kur do ta dërgoni ambasadorin në Izrael?”, ka pyetur deputetja Kadrijaj.

Ndërsa deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj, ka kërkuar të dijë se në sa organizata ka aplikuar Kosova për anëtarësim pas përfundimit të moratoriumit. “Marrëveshja e zotimeve në Uashington. Kosova do të bashkohet që ta zbatojë moratoriumin. Ky afat ka përfunduar në shtator. Pas kalimit të këtij afati në sa organizata ka aplikuar për anëtarësim dhe cilat janë ato? Ne jemi akuzuar për tradhti kombëtare për këtë çështje. Në cilat organizata planifikoni të anëtarësoheni”, ka thënë Selmanaj.

Ministrja e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, ka thënë se çështja e njohjeve të reja ka ngecur, duke thënë se kjo ka ndodhur për vite të tëra. Ajo ka thënë se janë duke punuar në këtë drejtim dhe se aplikimi për



anëtarësim në organizata të ndryshme do të ndodhë kur të sigurohen votat e mjaftueshme. “Interesimi është i madh rreth kësaj çështjeje. Është bërë një vit nga njohja e fundit. Do të kemi thellim të marrëdhënieve me Izraelin. Ka ngecur çështja e njohjeve jo vetëm këtë vit, por edhe në vitet paraprake. Ne po

punojmë në mënyrë të vazhdueshme për njohje të reja. Në kuadër të vizitës në Izrael do të bisedoj me kolegun tim dhe do të shikojmë se cila është mënyra më e mirë gjatë viteve të ardhshme. Sa i përket moratoriumit nga biseda të ndryshme me kolegë ministra nga shtetet mosnjohëse, është e

qartë që Serbia nuk e ka ndalur fushatën për çnjohje. Qeveria ka strategji të asaj se cilat organizata t'i adresojmë. Çështja e zotimit në Uashington është fakt. Tjetër është si mund ta korrigjojme këtë fakt. Ne do të aplikojmë kur i kemi votat në organizmat që i kemi të rëndësishme”, ka deklaruar Gërvalla.

## Raportet e Kosovës me Vatikanin mund të thellohen edhe më tej

PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim nuncin apostolik të Selisë së Shenjtë në Lubjanë, njëherësh delegat apostolik për Kosovën, monsinjor Jean Marie Speich.

Në takim është diskutuar mbi raportet e Republikës së Kosovës me Selinë e Shenjtë. Presidentja Osmani e ka falënderuar Speich për kujdesin që Vatikanin ka treguar në vazhdimësi ndaj popullit të Kosovës. Më tej, Osmani ka shprehur bindjen se raportet me Vatikanin mund të thellohen edhe më tej, gjithashtu edhe gatishmëria e institucioneve të vendit që të punojnë ngushtë me Selinë e Shenjtë për thellimin e këtij bashkëpunimi.

Në anën tjetër, monsinjor Jean



Marie Speich e ka falënderuar presidenten Osmani për pritjen dhe ka shprehur gatishmërinë e

tij dhe të Selisë së Shenjtë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe për thellimin e mëtejshëm të tij.

Edhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka pritur në takim Jean Marie Speich.

Konjufca ka vlerësuar lart mbështetjen e Vatikanit, duke theksuar se Selia e Shenjtë dhe personalisht Papa Gjon Pali II kanë qenë gjithmonë në përkrahje të aspiratave të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi.

Duke u fokusuar në rëndësinë e vendosjes së marrëdhënieve të plota diplomatike, kryetari Konjufca ka vënë në pah se njohja e pavarësisë nga shteti i Vatikanit do ta përshpejtonte procesin e integritit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian. Në takim është konfirmuar përkushtimi për avancimin e raporteve të ndërsjella dhe angazhimi i përbashkët për të përparuar në marrëdhëniet diplomatike me Selinë e Shenjtë.

## “Subvencionet I”, aktakuzë kundër 21 personave

PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër 21 të pandehurve në rastin e njohur si “Subvencionet I” në Ministrinë e Bujqësisë. Ata janë duke u ngarkuar me veprat penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Marrja e ryshfetit”, “Mashtrim në detyrë”, “Dhënia e ryshfetit”, “Mashtrim me subvencione” dhe “Falsifikim i

dokumenteve”. Aktakuza është ngritur kundër 11 të pandehurve si persona zyrtarë me inicialet L. S., S. Sh., B. N., H. M., K. Z., H. D., A. B., J. S., L. H., M. N., A. A., S. K. dhe kundër 10 të pandehurve si përfitues të subvencioneve me inicialet S. S., B. K., F. M., D. M., F. Z., D. K., K. B., A. A. dhe F. N. Të pandehurit me rastin e kryerjes së veprave penale kanë përfituar në mënyrë të

kundërligjshme në vlerë 646 mijë e 250 euro, ndërsa vlera e ryshfetit (korrupsionit) që kanë përfituar personat zyrtarë është 316 mijë e 650 euro. Prokuroria Speciale ka propozuar që të konfiskohet dobia pasurore nga të pandehurit e fituar me kryerjen e veprave penale, e cila kap vlerën e të hollave rreth 500 mijë euro, si dhe të disa veturave.







ZHVILLIMET NË UKRAINË, DEPUTETËT NË KOSOVË KËRKOJNË QË TË MBLIDHEN INSTITUCIONET E SIGURISË

# Kosova përkrah Ukrainës kundër agresionit të Rosisë

Kryeministri Albin Kurti, deputetët e pozitës dhe të opozitës kanë komentuar të martën zhvillimet e reja në Ukrainë, pasi ushtria ruse ka hyrë në territorin e këtij shteti. Kurti ka thënë se Qeveria e Kosovës mbështet sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të Ukrainës. Ndërkaq ish-ministri i Punëve të Jashtme, tani deputet i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që t'i përcjellin me vëmendje zhvillimet në Ukrainë. Ai ka propozuar që Kuvendi të nxjerrë një rezolutë për këtë çështje. Sipas tij, Ballkani mund të jetë fronti i dytë i Rosisë

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Qeveria e Kosovës mbështet sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të Ukrainës, ka thënë të martën kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, në të cilën deputetët e pozitës dhe ata të opozitës kanë kërkuar vëmendjen e qeverisë sa i përket situatës në Ukrainë, Kurti ka thënë se Kosova do të jetë "përherë e bashkërenduar me Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n".

Më 21 shkurt presidenti i Rosisë, Vladimir Putin, i njohu rajonet

separatiste në lindje të Ukrainës, Luhansk dhe Donjeck, si entitete të pavarura. Putini urdhëroi edhe vendosjen e trupave ruse atje. Vendet e Perëndimit dhe të tjera i dënuan këto veprime dhe paralajmëruan sanksione kundër Rosisë.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës në Kosovë ka reaguar në "Twitter", duke thënë se Putini ka bërë dhe po bën luftëra kundër demokracisë në Evropë. "Kosova qëndron me Ukrainën kundër agresionit të Rosisë. Putini edhe një herë po bën luftë kundër një demokracie paqësore. Ai ka bërë luftëra hibride kundër demokracive nëpër Evropë për vite me radhë. Bota e lirë duhet t'i përgjigjet

Putinit dhe përfaqësuesve të tij me vendosmëri", thuhet në reagimin e MPJD-së.

Gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Haki Abazi, ka pohuar se kriza me Ukrainën mund të përfshijë shumë shpejt edhe rajonin e Ballkanit. Ai ka theksuar se është urgjente që institucionet e Kosovës të sigurojnë të mblidhen dhe "të shqyrtojnë e monitorojnë me kujdes situatën, me të cilën bota është duke u ballafaquar". "Kërkesa ime është që në këtë situatë delikate të jemi të bashkuar përballë një krize që në mënyrë direkte apo indirekte na prekë të gjithë neve dhe rajonin", ka deklaruar Abazi.

Edhe deputet i PDK-së, Enver

Hoxhaj, ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që t'i përcjellin me vëmendje zhvillimet në Ukrainë, derisa ka propozuar që Kuvendi të nxjerrë një rezolutë për këtë çështje. Sipas tij, Ballkani mund të jetë fronti i dytë i Rosisë. "Në këtë drejtim mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet t'i përcjellë ngjarjet në Ukrainë. Nëse ka nevojë, në një të ardhme të afërt ta miratojmë një rezolutë dhe i ftoj të gjitha partitë politike që të bëjnë një gjë të tillë. Ukraina është fronti i parë, Ballkani është fronti i dytë. Ne jemi vija e parë e këtij fronti të dytë në Ballkan dhe mendoj që qeveria duhet ta mbledhë Këshillin e Sigurisë Kombëtare. E di që në të kaluarën ne e kemi mbledhur këshillin në situata të tilla", ka deklaruar Hoxhaj.

Për situatën në Ukrainë ka reaguar edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se në këtë kohë trazirash qëndrojmë me Ukrainën së bashku me aleatët tanë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe

Bashkimin Evropian. "Është detyrimi ynë t'i mbështesim vlerat e demokracisë dhe lirisë. Liria do të mbizotërojë!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Rusia është nën sanksione nga Perëndimi qëkur ka aneksuar Gadishullin ukrainas të Krimesë në vitin 2014. Në atë kohë Moskë ka nisur mbështetjen edhe për lëvizjen separatiste në lindje të Ukrainës. Kriza e fundit ka nisur në fund të vitit të kaluar, kur Rusia ka nisur grumbullimin e trupave në kufi me Ukrainën. Rusia ka kërkuar garanci nga NATO-ja se nuk do ta pranojë kurrë Ukrainën në radhët e saj, por aleanca ushtarake perëndimore e ka hedhur poshtë kërkesën e tillë, duke thënë se Ukraina, si shtet i pavarur, ka të drejtë t'i zgjedhë aleancat e veta.

Presidenti rus, Putin, ka thënë se Ukraina në NATO do të paraqiste kërcënim për sigurinë ruse. Ukraina ndan kufij me Rusinë dhe BE-në. Si ish-republikë sovjetike, ajo ka lidhje të thella sociale dhe kulturore me Rusinë.



# Kurti: Mërgata, pjesë integrale e fuqishme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 SHKURT - "Mërgata jonë është pjesë integrale e fuqishme e planit tonë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik", ka thënë kryeministri Albin Kurti në tryezën e organizuar mbi të drejtat e diasporës, të organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Duke theksuar rolin e pazëvendësueshëm që ka mërgata për Republikën e Kosovës, kryeministri Kurti bëri me dije nismat e qeverisë për ta angazhuar diasporën, marrë për bazë që diaspora sjell dy burime

shumë të rëndësishme në vend: të mirat materiale dhe njohuritë. "Ne e shohim mërgatën si kapital njerëzor para se ta shohim si kapital financiar", ka shprehur mendimin kryeministri. "Për këtë arsye jemi duke u fokusuar në krijimin e programit nacional, që në bazë ka transferimin e dijes dhe përvojës nga mërgata në Kosovë", ka thënë ai. Duke vlerësuar se diplomacia dhe diaspora janë të pandashme në shumë fusha, kryeministri ka bërë me dije angazhimin e qeverisë për zhvillimin e një dialogu të gjithanshëm me qytetarët tanë jashtë vendit, si dhe punën për një strategji të re për diasporën, edhe një projektligj të ri.



## Kuvendi miraton tri marrëveshje ndërkombëtare



PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Kuvendi i Kosovës në seancën e së martës ka miratuar tri marrëveshje ndërkombëtare. Deputetët miratuan Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për statusin e Forcave në mes të Kosovës dhe shtetit të Kuvajtit. Po ashtu, deputetët i dhanë dritë të gjelbër edhe ratifikimit të marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi në kontekstin e aderimit në Bashkimin Evropian. Deputetët e Kuvendit të Kosovës

kanë miratuar edhe marrëveshjen me Maqedoninë e Veriut për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile. Përkrahje këtyre marrëveshjeve i dhanë deputetët nga pozita dhe opozita. Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka folur rreth marrëveshjes me Maqedoninë e Veriut për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile. "Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është forcimi i mëtejshëm i

bashkëpunimit në fushën e ndihmës juridike, në fushën civile dhe tregtare mes dy vendeve dhe lehtësimi i procedurave ligjore në këtë fushë. Kjo marrëveshje zbatohet për çështjet që përfshijnë procedurat me gjendjen civile, familjare, marrëdhëniet e punës, çështjet e pronësisë dhe marrëdhëniet e tjera civile dhe tregtare të personave fizikë dhe juridikë", ka thënë ministrja Haxhiu.

## Krasniqi, ambasadorit amerikan: PDK-ja do të japë kontribut për temat nacionale



PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur të martën në takim ambasadorin e ri amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier. Krasniqi ka thënë se

ambasadorit Hovenier i ka uruar mirëseardhje në Kosovë, duke i ofruar bashkëpunimin e Partisë Demokratike të Kosovës.

Lideri i PDK-së ka bërë me dije se bashkë me ambasadorin amerikan kanë diskutuar edhe

për tema të ndryshme në raport me zhvillimet aktuale politike në vend. "Ambasadorin Hovenier e sigurova se Partia Demokratike e Kosovës, si lidere e opozitës, do të jetë gjithmonë e gatshme të japë kontributin e saj për temat e

interesit nacional, veçanërisht për fuqizimin e mëtejshëm të raporteve Kosovë - ShBA. Po ashtu, me ambasadorin Hovenier diskutuam shtruar për prioritetet e përbashkëta strategjike në fushat e qeverisjes

së mirë, zhvillimit ekonomik dhe integritit euroatlantik. Ambasadorin Hovenier e falënderova për mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së dhënë Kosovës në të gjitha fushat", ka thënë Krasniqi.



# Krijimi, shkrimi dhe përpjekja për rishkrim të historisë së Kosovës!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

## Kur të tjerët ta shkruajnë historinë:

Shqiptarët, pavarësisht ku kanë jetuar dhe ku jetojnë, kanë problem me historinë sepse asnjëherë nuk u shkon për shtati, prandaj lindi ngatërresat, sidomos gjatë interpretimit të saj. Historia e shqiptarëve është si lëkura e leopardit, në periudha të caktuara kohore është e ndriçuar apo pjesërisht e ndriçuar, kurse në periudha të tjera është krejtësisht e pandriçuar, errësirë informative dhe kjo errësirë zgjatë me shekuj të tërë. Historia jonë është kaq shekuj nën Perandorinë Romake, nën Bizantin, nën Perandorinë Otomane, nën bullgarët, italianët, gjermanët, jugosllavët, kinezët dhe të tjerëve, prandaj më shumë apo kryesisht kemi qenë kontribuues të historisë për ata që na kanë mbajtur në robëri se që kemi krijuar historinë tonë. Është një listë e gjatë e shqiptarëve që kanë krijuar emër dhe famë duke u shërbyer të tjerëve sesa që kanë shërbyer për popullin dhe vendin e tyre. Po ndalemi te historia më e re në Shqipëri dhe në Kosovë. Para

Luftës së Dytë Botërore historia e shqiptarëve dhe e Shqipërisë përshtatej me ata që ishin në pushtet të cilët fillimisht ishin patriotë, kurse pasi Shqipëria u shndërrua dhunshëm në mbretëri, pa asnjë traditë mbretërore, patriotët që e shpallën Pavarësinë e Shqipërisë u ndoqën dhe u përndoqën nga Ahmet Zogu si tradhtarë, një pjesë e të cilëve u vranë dhe u arrestuan, qoftë nga regjimi i Zogut ashtu edhe nga regjimi komunist i Enver Hoxhës. Me ikjen nga Shqipëria pas sulmit të Italisë fashiste, edhe Ahmet Zogu u shpall tradhtar. Pas Luftës së Dytë Botërore e tërë historia e Shqipërisë u shkrua sipas standardit të Enver Hoxhës dhe Partisë së Punës së Shqipërisë, deri kur u shemb sistemi komunist. Pastaj historia e Shqipërisë shkruhej sipas rrethanave të reja, përkatësisht sipas standardeve të demokracisë së pakonsoliduar dhe Sali Berishës, Fatos Nanos dhe tash sipas Edvin Ramës. Në këtë mënyrë historia e Shqipërisë u bë si lakrori me disa petë të secili që vinte në pushtet

e mbulonte petën e historisë paraprake me petën e vet të historisë së glorifikuar dhe pa asnjë mbështetje shkencore. Kjo ka shkaktuar shumë probleme në Shqipëri e që po shkaktonte edhe sot shumë probleme aq më parë që ka prodhuar shumë pasoja edhe në Kosovë dhe vendet e tjera ku jetojnë shqiptarët.

## As Kosova nuk bën përjashtim:

Sa i përket historisë, Kosova ishte në pozitë më të vështirë. Në njërin anë ishte ndikimi i madh i Shqipërisë komuniste kurse, në anën tjetër, ndikimi jugosllav dhe i Titos. Patriotët e vërtetë dhe nacionalistët midis përzgjedhjes për Enver Hoxhën apo Josip Broz Titon, përcaktoheshin për Enver Hoxhën, prandaj thuaja të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë në ish-Jugosllavi, pavarësisht prej bindjeve politike nga regjimi jugosllav dhe serb, cilësoheshin dhe dënoheshin si enveristë. Komunistët shqiptarë të Kosovës ishin rreshtuar në krahë të Titos dhe udhëheqësve të Serbisë dhe punonin, edhe kundër Shqipërisë sikur edhe kundër

popullit shqiptar të Kosovës deri në pjesëmarrje aktive në krime kundër shqiptarëve si në Drenicë, Masakra e Tivarit, në Llap, në Anamoravë, në Prizren ku nënshkruan që Kosova të mbetej në Jugosllavi dhe krime të tjera të panumërta. Këta ishin kriminelë të komunizmit sllav dhe serb dhe për krimet asnjëherë nuk dhanë përgjegjësi, ndërkaq që të mirat më të mëdha i gëzuan në kohën kur do të duhej t'i nënshtroheshin përgjegjësisë administrative dhe penale, në kohën pas përfundimit të luftës së të Lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Se cila ka qenë historia e Kosovës nga viti 1945 e deri në vitin 1990, të gjithë që kanë jetuar në atë kohë e kanë të qartë; histori që glorifikon komunizmin jugosllav dhe serb dhe që e heshtë apo nëpërkëmb historinë e vërtetë të shqiptarëve të Kosovës. Ishin "heronj" ata që e dëmtuan fort Kosovën shqiptarët, qoftë si politikanë të shitur, anëtarë të OZNS-së, të UDB-së, hetues që përgjakën duart me gjakun e patriotëve të vërtetë, prokurorë dhe gjykatës,

intelektualë dhe historianë të shitur dhe llaskuçë dhe të tjerë. Po cila ishte dhe është historia e sotme e Kosovës thuaja 23 vjet pas përfundimit të luftës dhe 14 vjet pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës? Nuk ka ndryshime cilësore dhe nuk përmban historinë e vërtetë për faktin se shumica e atyre që e shkruan historinë e Kosovës pra vitit 1998, tash, në rrethana të reja dhe përshtatëse, e shkruan një histori që të bën të vjellësh. Lufta e UÇK-së është në margjina, kontribuuesit kryesorë si Baca Adem Demaçi, Shaban Polluzha, Fazli Grajçeci, Xheladin Rekalio, Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Hoxhë Idriz Gjilani, Gjon Serreçi dhe Marie Shllaku, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Agim Ramadani dhe Salih Çekaj, Shaban, Adem dhe Hamëz Jashari dhe shumë të tjerë përmenden vetëm për qëllime politike, qoftë gjatë paraqitjeve publike për vota, ashtu edhe në librat e historisë. Realisht, definicioni i Kosovës si shtet shumetnik, me së paku 93 % shqiptarë, llaskuçëria ndaj ndërkombëtarëve dhe lufta kundër bartësve kryesorë të



luftës së lavdishme të UÇK-së e ka krijuar një perceptim se të jesh patriot është diçka e keqe, të lidhin me hajni dhe krim të organizuar pikërisht nga ata që nuk kanë bërë asgjë për këtë vend dhe këtë popull, për më keq tërë kohën kanë qenë, edhe kundër luftës si dhe kundër popullit, gjuhën e të cilit e flasin. Prandaj edhe nuk mund ta keni një histori tjetër, një histori kombëtare që pasqyron realisht ngjarjet, rezistencën, luftën dhe vuajtjet e shqiptarëve të Kosovës, që nga viti 1945 e deri më sot. Historinë më të re dhe më të lavdishme të shqiptarëve dhe të Kosovës e shkruan këta që e bënë luftën e fundit në Kosovë, në rrethana dhe kushte jashtëzakonisht të pabarabarta kundër një shteti të fuqishëm, me një armatë të fuqishme dhe me armatim modern dhe të sofistikuar. E bënë kryesisht ish-të burgosurit politikë apo edhe ata që u përndoqën nga regjimi jugosllav, serb dhe shqipfolësit e vendit. Shtetet që më vonë e përkrahën luftën ekzistonin me qindra vjet dhe, në shumë raste më shumë e dëmtuan popullin shqiptar se që e ndihmuan. Edhe NATO nuk ishte themeluar në vitin 1998 për të intervenuar në vitin 1999. Po të mos ishte lufta e vazhdueshme dhe e vendosur çlirimtare e shqiptarëve dhe qytetarëve të tjerë të Kosovës dhe të viseve të tjera ku jetojnë shqiptarët, as nuk do të kishim përkrahje ndërkombëtare e as nuk do të kishte bombardim të NATO-s. Ata që e kundërshtuan dhe e luftuan luftën çlirimtare mendojnë ndryshe. Po këta, edhe sot janë përndjekësit më të mëdhenj të patriotëve shqiptarë dhe mohuesit më të mëdhenj të luftës çlirimtare të UÇK-së. Po

këta sajuan dhe sajojnë dosje për ata që u keqtrajtuat nga Tribunali i Hagës, gjykatat e UNMIK-ut dhe EULEX-it dhe këta që brutalisht po dhunohen nga Gjykata Raciste Speciale në Hagë. Pasi u liruan nga llogoret e ish-Jugosllavisë shumica e vazhduan aktivitetin politik dhe patriotik. Nuk kishim përkrahje ndërkombëtare. Madje, në takimin që në vitin 1990 e patën në Beograd Baca Adem Demaçi, Ibrahim Rugova dhe Veton Surroi me sekretarin e Shtetit, Xhejms Bejker, iu bë e ditur se ShBA-ja e përkrah integritetin territorial të Jugosllavisë dhe se shqiptarët e Kosovës duhet të kërkojnë zgjidhje dhe të drejta brenda këtij integriteti territorial duke e përjashtuar çdo ndarje nga ish-Jugosllavia. Veton Surroi është gjallë, ekziston edhe incizimi i atij takimi se çka folën Baca Adem Demaçi, Ibrahim Rugova dhe Veton Surroi. Zhvillimet pas Konferencës së Rambujesë janë kryesisht të favorshme për Kosovën, jo pse delegacioni i Kosovës e nënshkroi Marrëveshjen, por pse Serbia dhe Millosheviqi, në saje të vlerësimeve të gabuara, e refuzoi nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje. Merreni me mend po ta nënshkruante Serbia këtë Marrëveshje?! Një Marrëveshje e tillë e nënshkruar do ta legjitimonte ndërkombëtarisht praninë e Serbisë në Kosovë dhe kjo më nuk do të zhbëhej. Shiheni, një Asociacion i Komunave Serbe në Kosovë çfarë problemi po na shkakton. E tash krahasojeni me Rambujenë! Nga kjo situatë të gjithë bëhen të mençur, të gjithë bëhen trima dhe të gjithë janë patriotë, edhe ata që ishin pjesë e delegacionit të cilët me robër,

me shtëpi e me qen dhe me thi i kishin shërbyer Jugosllavisë dhe Serbisë. Dhe të gjithë morën të drejtën ta pushkatojnë publikisht Bacën Adem Demaçi që e kundërshtoi këtë marrëveshje. Dhe po të njëjtët sot e shkruajnë dhe e rishkruajnë historinë e Kosovës.

**Shpallja e pavarësisë:** Më së lehti dhe më përmbajtjesore do të ishte shpallja e pavarësisë së Kosovës në muajin qershor 1999. Serbia ishte në nokdaun, gjendja në terren ishte fakti më bindës për përkrahësit e pavarësisë dhe po të bëhej në atë kohë, sot do ta kishim harruar problemin me Serbinë. Po ndërkombëtarët turrin lesh duke i dhënë kohë dhe duke ndihmuar Serbinë në konsolidimin politik, ekonomik, ushtarak dhe shtetëror. Në vitin 2008, përkatësisht më 17 shkurt 2008, u shpallë një pavarësi e mbikëqyruar e Kosovës, nën kujdestari të ndërkombëtarëve duke i lënë Serbisë hapësirë të ndërhyjë papengueshëm në punët e brendshme të Kosovës përmes decentralizimit në baza etnike, zonave të mbrojtura, vendet e rezervuara dhe një ligji çoroditës diskriminues që quhej diskriminim pozitiv. Të gjitha këto e minonin dhe e defunksionalizonin pavarësinë e Kosovës duke e rrezikuar integritetin territorial dhe duke mos e lejuar shtrirjen e sovranitetit brenda këtij integriteti territorial. E tash, kush do ta lexonte Deklaratën e Pavarësisë?! Në një vend normal ku vlerësohet sakrifica, integriteti i personalitetit dhe reputacioni vendor dhe ndërkombëtar, Baca Adem Demaçi do të duhej të ishte ai që

do ta lexonte Deklaratën e Pavarësisë. Po këto nuk ishin kritere që vlerësoheshin andaj mbetën tre persona, kandidatë të mundshëm për ta lexuar Deklaratën e Pavarësisë: Fatmir Sejdiu, president, Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe Hashim Thaçi, kryeministër. Fatmir Sejdiu ishte përjashtuar menjëherë dhe ishte vendosur që këtë ta bëjë Hashim Thaçi sepse as Jakup Krasniqin nuk e lejuan. Këto janë fakte që nuk mund të mohohen nga askush pavarësisht prej rrethanave të reja. Çdo përpjekje për ta mohuar këtë fakt është përpjekje për rishkrim të historisë dhe falsifikim i të vërtetës. Është antinjerëzore, është antikombëtare dhe kundër çdo logjike të shëndoshë. Këto përpjekje nuk dallojnë aspak nga përpjekjet që po i bën Gjykata Raciste Speciale për rishkrim të historisë së Kosovës dhe të shqiptarëve përmes kriminalizimit të një lufte çlirimtare. Përralla janë pohimet se nuk po dënohet UÇK-ja, por individët brenda saj për faktin se nuk ka mbetur udhëheqës politik apo ushtarak i UÇK-së që nuk është arrestuar, gjykuar apo dënuar nga Tribunali i Hagës, gjykatat e UNMIK-ut, EULEX-it, gjykatat e Serbisë dhe tash Gjykata Speciale Raciste. Sa më shumë mundoheni ta fshehni këtë të vërtetë ajo bëhet më e madhe dhe më e lavdishme! Albin Kurti, me më shumë se 50 % të votave, në asnjë mënyrë nuk është dashur ta anashkalojë kontributin e atyre që e krijuan dhe shkruan historinë dhe që e lexuan Deklaratën e Pavarësisë sepse nuk i bën aspak nder, as si kryeministër, as si politikan, as si njeri e as si shqiptar. As opozita

nuk është dashur ta lëshojë seancën solemne të 17 shkurtit 2022, aq më parë që në mesin e opozitës ishin shumë personalitete që e krijuan dhe e shkruan historinë më të re të Kosovës. Kjo ishte e turpshme, ishte e papranueshme dhe e pafalshme, sikur mohimi i kontributit të atyre që po mbahen si pengje në Hagë, të tjerëve që kontribuuan për këtë histori, qoftë edhe shumë gjysmake e që ishin edhe në radhët e opozitës dhe, në një numër më të vogël, edhe të opozitës. Dikush e feston mbrëmjen e maturës edhe pas 50 vjetëve, të tjerët edhe përvjetorin e martesës pas, gjithashtu, 50 vjetëve, por as të parët e as të dytët nuk mund ta rikthejnë ditën e maturës dhe të martesës në dimensionin dhe emocionin e asaj dite, vetëm mund ta simulojnë këtë ditë. Edhe tani mund të simulohet Leximi i Deklaratës së një Pavarësie tjetër dhe në vend të Hashim Thaçit mund ta caktoni kënd të doni i cili nuk e ka as emrin Hashim e as mbiemrin Thaçi. Por ky simulim nuk e ndryshon historinë dhe nuk e rikthen emocionin përveçse e mundëson një hakmarrje, qoftë edhe virtuale dhe të simuluar, si akt jashtëzakonisht i ulët njerëzor. Njeriu i pushtetshëm kur e ka pushtetin absolut duhet të tregohet modest dhe i papushtetshëm sikur që njeriu i mençur nuk e shpërdorë mençurinë për hakmarrje dhe ndëshkim të atyre që nuk kanë pushtet dhe nuk janë shumë të mençur. Kjo është ligësi dhe fundi asnjëherë nuk do të jetë i mirë. Mos u kënaqni me varfërinë e të tjerëve dhe mos u gëzoni në fatkeqësinë e të tjerëve. Sepse, edhe të parën si dhe të dytën do ta keni para dere. Albin Kurti duhet të merret me të tashmen dhe të ardhmen dhe në këtë kontekst duhet të kërkojë bashkëpunëtorë, si nga pozita që e ka 100 % nën kontroll, por edhe nga opozita që aktualisht më së paku i ngjan opozitës, por që Albin Kurti mund ta shndërrojë në opozitë të fuqishme nëse vazhdon ta shpërfillë aktualisht dhe historikisht. Proceset që e presin Kosovën nuk mund të mbulojnë vetëm me kapelën e Albin Kurtit dhe përgjegjësia është e madhe dhe e padurueshme vetëm për një person. Pastaj, as Borrelli dhe Lajçaku, përkundër simpatisë antologjike për një marrëveshje të favorshme për Serbinë, e kanë të qartë se pa opozitën nuk do të ketë marrëveshje përfundimtare. Albin Kurti, si kryeministër me më shumë se 50 % të votave, ka përgjegjësi që më shumë të punojë me opozitën se me pozitën. Nuk ka rrugë tjetër! Edhe një ditë nëse vonohet marrëveshja, për Kosovën do të jetë një ofertë më e keqe, ndërkaq që marrëveshja nuk ka alternativë, nuk po na ofrojnë një alternativë tjetër!





QËNDRIMI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR NDAJ KËRKESAVE TË SHQIPTARËVE TË KOSOVËS PËR PAVARËSI 1990-1999 (4)

# Qëndrimi i faktorit ndërkombëtar gjatë viteve 1998-1999



Prof. dr. Sabit SYLA

Në kushtet e dhunës së vazhdueshme policore serbe dhe mungesës së perspektivës për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, organizimi i rezistencës së armatosur u pa si e vetmja alternativë për çlirim të Kosovës dhe zgjidhjes së çështjes së saj. Shqiptarët u detyruan të organizoheshin për vetëmbrojtje e luftë të armatosur, me qëllim që t'i mbrojnë vatrat dhe tokën e tyre, dhe për të fituar lirinë. Ndonëse celulat e para të organizimit të rezistencës së armatosur i hasim qysh në fillim të viteve 1990, 28 nëntori i vitit 1997 shënon daljen publike në skenë të Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës, në fshatin Llaushë të Skenderajt. Pavarësisht se misioni i UÇK nënkuptonte luftën për të drejtën legjitime të një populli për liri, dhe se në ballafaqim me UÇK-në forcat serbe kishin ushtruar dhunë të paparë ndaj civilëve të paarmatosur, komuniteti ndërkombëtar, vazhdoi me të njëjtat pretendime për respektimin e të drejtave të njeriut dhe sigurimin e një autonomi në kuadër të Serbisë. Madje, Robert Gelbard, emisar special i presidentit Clinton, kishte deklaruar në mars 1998, se "UÇK është një organizatë terroriste". Një deklarim i tillë i dha pretext të qartë Millosheviqit që të fillojë serinë e parë të sulmeve të shkallës së gjerë kundër popullatës civile, duke vrarë një numër civilësh të paarmatosur. Sidoqoftë, ka të ngjarë se prapa një deklaratë të tillë qëndron papërgjegjësia apo tejkalimi i kompetencave nga Gelbardi, pasi nuk besohet se ShBA-ja ta ketë dhënë dritën jeshile për një veprim të tillë. Po

ashtu, ai mund të jetë ngatërruar me ide të ndryshme brenda komunitetit ndërkombëtar që mund të shkonin deri në atë shkallë sa të mendonin për eliminimin e UÇK-së, nënshtrimin e shqiptarëve dhe arritjen e asaj çfarë kërkonte komuniteti ndërkombëtar - mosndryshimin e kufijve. Pavarësisht deklaramëve të Gelbardit dhe të bashkëmendimtarëve të tij, UÇK ishte ushtri tipike çlirimtare. UÇK-ja nuk kishte të bënte me asnjë nga variantet e terrorizmit. Ushtria Çlirimtare e Kosovës iu kundërvu agresionit serb duke u mbështetur në të drejtën që kanë popujt për t'u mbrojtur nga dhuna e agresioni si dhe për t'i sjellë atij çlirim kombëtar. Rruga e luftës së armatosur në formë të organizimit ushtarak u pa si e vetmja alternativë për çlirim të Kosovës dhe zgjidhjen e çështjes së saj. Regjimi policor dhe ushtarak serb i Millosheviqit ishte shkaktari kryesor i përkeqësimit dhe i radikalizimit të situatës në vend, te

cilët ndiqnin, arrestonin, burgosnin, rrihnin, maltretonin dhe vrisnin popullsinë shqiptare e kontrollonin me forcë territorin e pushtuar, që nuk u përkiste atyre, por popullit autokton shqiptar. Këmbëngulja e UÇK-së dhe shkalla e paarsyeshme e dhunës së ushtruar nga autoritetet policore serbe kundër popullatës civile, bënë që komuniteti ndërkombëtar në pjesën e parë të vitit 1998 ta modifikonte qëndrimin ndaj Kosovës. Një nga përfaqësuesit e BE-së kishte deklaruar se BE refuzonte të pranonte se Kosova është një çështje e brendshme e Jugosllavisë. Me fjalë tjera, lufta e armatosur e UÇK, që u manifestua edhe me aktin sublim të Jasharëve në Prekaz, vuri Kosovën në tryezën e diskutimeve të komunitetit evropian. Çështja e Kosovës u trajtua nga Bashkimi Evropian, Grupi i Kontaktit, Këshillin e Ministrave të Bashkimit Evropian, etj., të cilat ofruan alternativa të ndryshme për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Nga propozimet më të rëndësishme ishte ai i Grupit të Kontaktit i datës 9 mars 1998, i cili doli me propozimin për "... një autonomi substanciale për Kosovën, që do të shprehej me vetë-administrimin e saj përmbajtësor, duke funksionuar si njësi më vete brenda Serbisë, e jo në kuadër të Jugosllavisë". Nuk ka asnjë dyshim se një ofertë e tillë paradoksale ishte e papranueshme për shqiptarët e Kosovës.

federativ do të kishte kompetenca në fushën e mbrojtjes, politikës financiare dhe të politikës së jashtme. Vëmendja ndaj kësaj ideje konsistonte në faktin se nuk kishte nevojë për ndryshimin e kufijve ndërkombëtar të Jugosllavisë, edhe pse sipas logjikës së Komisionit të Badinterit Republika e Kosovës do të ishte kandidatë për njohje si një shtet i ri. Mali i Zi u shpreh kundër, sepse një skemë e tillë ia zbehte atij rolin në federatë. Por, as serbët e as shqiptarët nuk do të pranonin një skemë të tillë. Si do të mund të jetonin shqiptarët nën sigurinë e një ushtrie që kreu masakra, vrasje e depërtime, apo në anën tjetër, si mund të pranonte Serbia një republikë të Kosovës kur aq shumë energji e propagandë ishte harxhuar e kur shumë mite për serbizmin e kishin gjenezën në Kosovë.

Sidoqoftë, gjatë fundit të marsit dhe gjatë gjithë prillit 1998 ShBA dhe Bashkimi Evropian, respektivisht mekanizmat përkatës nën drejtimin e këtyre subjekteve, dolën me ide dhe propozime të ndryshme për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, që fillonin nga një autonomi politike e administrative, autonomi e zgjeruar, republikë me kusht, republikë me kompetenca jo si të Malit të Zi, por jo më pak se "Republika Srpska" në Bosnjë Hercegovinë, republikë në kuadër të ish-Jugosllavisë pas një prove transitive të vetëqeverisjes së vetë suksesshme prej 3 vitesh, etj. Por, sikurse shihet, asnjëra nga këto propozime nuk e parashihte pavarësinë e Kosovës, pra gjitha ato, pak a shumë, parashihnin gjetjen e një lloji modeli përmes së cilës Kosova do të mbetej nën Serbi, ndonëse ishte e qartë se asnjëra nga këto propozime nuk do të pranohej nga shqiptarët e Kosovës, sepse binin ndesh me parimet themelore të luftës çlirimtare. (Vijon)



## Zviceranët urojnë për 14-vjetorin e pavarësisë së Kosovës

Bern, 22 shkurt - Për nder të 14-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, Ambasada e Kosovës në Bern të Zvicrës, e udhëhequr nga Sami Ukelli, ka organizuar pritje për diasporën shqiptare. Në këtë përvjetor kanë qenë të ftuar shumë personalitete të diasporës shqiptare, por edhe afaristë të shumtë. Ndër ta ka qenë edhe afaristi shqiptar Arsen Shoshi, i cili është drejtor për Investime në 'Benedict Education Group' dhe anëtar i bordit të këtij institucioni me renome ndërkombëtare, e shtrirë me

shkolla në 80 shtete të botës. Po në këtë festë shtetërore ka qenë i pranishëm edhe Heinrich Mister, drejtor gjeneral i 'Benedict Education Group'. Gjatë kësaj ceremonie të pranishmit dhe popullin e Kosovës përpos Shoshit, i ka përshëndetur dhe uruar edhe Heinrich Mister, duke uruar për 14-vjetorin e pavarësisë të gjithë popullin shqiptar. Ndërsa Arsen Shoshi, i cili njihet si afarist dhe humanist i madh ndër shqiptarë, e i cili në këtë institucion arsimor

punon që 18 vjet, në cilësinë e drejtorit për investime në 'Benedict Education Group', ka uruar qytetarët e Kosovës. "Prania kaq e madhe e pjesëmarrës e bën madhështor 14-vjetorin e pavarësisë sonë, sepse një kontribut të madh për këtë prani të qytetarëve e biznesmenëve zviceranë e ka dhënë diaspora shqiptare që veprom në Zvicër", ka thënë ai. Ai ka dhënë edhe një mesazh për zhvillimet në Kosovë, duke theksuar se është punuar shumë, por ka hapësirë që të punohet edhe




më shumë.

Shoshi ka thënë se prioritet duhet të jetë edhe diaspora

shqiptare sepse, sipas tij, me punë Kosova do të bëhet një Zvicër e dytë.



# Nga Snouden tek Pegasus: Çfarë është spiunazhi në epokën dixhitale?



**Nga Carl-Johan KARLSSON**  
"World Crunch"

Shkrimtarja e famshme Xhejn Ostin, shkroi në vitin 1816 se "çdo njeri është i rrethuar nga një lagje plot me spiunë vullnetarë". Sot kjo "lagje" po bëhet disi më e madhe, teksa jetët dhe ekonomitë tona të dixhitalizuara, por nxjerrin në pah "lumenj" gjithnjë e më të thellë të të dhënave private nga jeta e përditshme e qytetarëve.

Natyrisht, kjo ka sjellë me vete edhe një debat gjithnjë e më të zjarrtë, mbi atë se çfarë do të thotë në të vërtetë "vullnetar" dhe "spiunim", në një botë ku mbikëqyrja nuk është vetëm e kudogjendur. Megjithatë ajo po shpallet si një kusht kryesor për sigurinë tonë private dhe kolektive.

Një shembull i mirë na vjen së fundmi nga Danimarka, ku policia daneze njoftoi muajin e kaluar se Lars Findsen, ish-shef i Shërbimit të Inteligjencës Daneze të Mbrojtjes (DDIS), mund të përballet me deri 12 vjet burg për tradhti, për shkak të akuzave për rrjedhjen e informacionit të klasifikuar.

Vetëm disa ditë më vonë, skandali u zgjerua më tej pasi Klaus Hjort Frederiksen, Ministër i Mbrojtjes në vitet 2016–2019, konfirmoi se po përballet me akuzat e ngjashme, sikurse raportoi e përditshmeja daneze "Politiken".

Akuzat kundër Frederiksen pasuan komentet e tij në mediat lokale 2 vitet e fundit, mbi një marrëveshje tepër sekrete dhe

afatgjatë midis Danimarkës dhe SHBA-së mbi përgjimin dhe mbikëqyrjen e internetit, duke i dhënë mundësi Uashingtonin të përdorë të dhënat daneze për të spiunuar vendet evropiane dhe politikanët e saj, përfshirë ish-kancelaren gjermane Angela Merkel.

Meqë autoritetet daneze kanë bërë pak deklarata publike mbi këtë çështje, historia është ende e mbuluar me mister. Por ajo që zemëroi më shumë danezët pas zbulimeve të vitit 2020, ishte fakti që edhe ata ka të ngjarë të spiunohen si pasojë e marrëveshjes së fshehtë të përgjimeve.

Muajin e kaluar, Ministri danez i Drejtësisë, Nik Hakerup, e quajti paradoksale situatën, duke shtuar se "fshehtësia e shërbimit të inteligjencës, është pjesë e themelit që ruan lirinë tonë".

E njëjta çështje shkaktoi tensione në fillim të këtij muaji në Izrael, ku qeveria nisi një hetim mbi raportet se policia ka përdorur në mënyrë të paligjshme programin e spiunazhit të kompanisë private NSO, "Pegasus", kundër qytetarëve të saj pa një urdhër gjykatë, përfshirë një dëshmitar të rëndësishëm në gjyqin për korrupsion kundër ish-kryeministrit Benjamin Netanjahu.

Hetimi, i zbuluar nga revista e biznesit në Tel Aviv "Calcalist", vjen pas disa vitesh raportimemediale se NSO, e ka shitur "Pegasus" nën licencën e Ministrisë izraelite të Mbrojtjes tek qeveritë e ndryshme autoritare, të

cilat në vend se të kapin terroristët, e kanë përdorur atë për të hakëruar telefonat e aktivistëve dhe politikanëve të opozitës.

Një nga vendet më të lira në botë, ka tani versionin e saj të skandalit Snouden. Në fakt, që kur Eduard Snouden e çimentoj emrin e tij në histori, pasi ishte autor i rrjedhjes më të madhe të informacioneve të klasifikuara në historinë e SHBA-së, ne na rikujtohet në vijimësi se mbikëqyrja shtetërore kufizohet rallë (në mos asnjëherë?) tek një grup i vogël njerëzish të këqij.

Dhe kjo ngre pyetjen: Si ta rimarrim të drejtën tonë individuale për privatësi, pa e cenuar sigurinë tonë kolektive? Ndërsa sulmet e 11 shtatorit 2001, dhe vala pasuese e terrorizmit në të gjithë Evropën, i nxitën qeveritë të zgjerimin kapacitetet e vëzhgimit, ne u siguruam sepjekuria e demokracive perëndimore do e bënte të pajustifikuar çdo lloj frikë, se mos masat përdorëshin për qëllime të këqija.

Është shumë domethënë fakti që Danimarka, një nga vendet më të lira dhe më të besueshme në botë, ka tani versionin e saj të skandalit Snouden, natyrisht disi me i qetë në krahasim me ngritjen e liderëve autoritarë në Perëndim, të cilët janë shumë më të zhurmsëm dhe isfidojnë më hapur parimet demokracisë.

Tani shumë analistë argumentojnë se politika e mbikëqyrjes, duhet të përfshijë jo vetëm një rikthim të praktikave të caktuara, por edhe të masave mbrojtëse më të forta kundër tejkalmittë kufijve që dikton ligji dhe abuzimit të

qeverive në të ardhmen.

Profesor Lorenc Kapelo argumenton në librin e tij "Nuk është puna juaj: Privatësia në SHBA, nga Epoka e Artë në Epokën Dixhitale", se korniza të tilla ligjore nuk do të jenë aq të lehta për t'u vendosur, kryesisht sepse ligjet janë gjithmonë një hap prapa zhvillimit të teknologjisë.

Kjo është sot akoma më e vërtetë, pasi shpejtësia e përparimit të teknologjisë po rritet në mënyrë eksponenciale, dhe kur një rrjet i gjerë pajisjesh e kanë bërë kapacitetin mbikëqyrës një parakusht për funksionimin e shoqërisë sonë tekno-centrike.

Ndaj sot nuk ka asnjëherë garanci, se shërbimet sekret do t'i përmbahen ligjit në veprimtarinë e tyre. Por edhe me vendosjen e barrierave ligjore, nuk ka asnjëherë garanci se shërbimet e inteligjencës do t'i respektojnë ato. Tek e fundit, çështja kryesore deri më tani nuk ka qenë mungesa e rregulloreve, por një sistem ku optimizimi i ndikimit shtetëror, vendas dhe të huaj, është një prioritet brenda aparatit të sigurisë shtetërore, dhe i tejkalon të drejtat e privatësisë dhe konsideratat ligjore.

Siç u shpreh vetë Snouden në një intervistë të fundit për "Politiken", në vazhden e skandalit të spiunazhit danez, nëse Danimarka i jep SHBA-së qasje në sasi të mëdha të të dhënave, nuk ka gjasa që informacionet që nuk lidhen me kërcënimet e drejtpërdrejta të sigurisë, t'i kthehen në mënyrë miqësore Kopenhagës.

"Nuk bëhet fjalë që Danimarka të jetë armike e SHBA-së. Por NSA është pjesë e një shteti që synon të maksimizojë fuqinë dhe ndikimin e saj në të gjitha anët e botës. Prandaj, është detyra e SHBA-së që ta kuptojë Danimarkën, qeverinë daneze, dhe hierarkinë në ushtrinë e saj" – shprehet ai.

Megjithatë, fati ynë mund të jetë përfundimisht në duart e sektorit privat. Më në fund, pas shumë vitesh shurdhërie ndaj shqetësimeve të publikut, gjigantët e teknologjisë si "Google" dhe "Apple" mund të zgjohen nga nevoja për barriera të forta të privatësisë, si një kusht për të mbajtur klientët e tyre.

Në janar të këtij viti, "Google" dhe "Boston Consulting Group" publikuan një studim të përbashkët, që tregon se gati gjysma e konsumatorëve në Kanada dhe SHBA, nuk ndiheshin komodë me ndarjen e të dhënave të tyre për të pranuar reklamën e synuar.

Ndërkohë, një Anketë e të Drejtave Themelore të BE-së për vitin 2020, një studim i kryer në kohën kur qeveritë po diskutonin përdorimin e teknologjisë për të luftuar përhapjen e Covid-19, tregoi se 41 për qind e evropianëve nuk duan të ndajnë asnjë të dhënë personale me kompanitë private. Pra ndërsa është thënë shpesh se shumë njerëz nuk do të heqin kurrë dorë nga shërbimet e internetit për t'u bërë një pengesë në mbledhjen e të dhënave, në fund mund të jenë vetë qytetarët ata që duhet ta kryejnë këtë punë. /World Crunch – Bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Drita synon t'u rikthehet fitoreve ndaj Malishevës

Sot zhvillohen tri ndeshje në Superligë, kurse ndeshja derbi do të jetë në mes të Malishevës dhe Dritës. Ardian Nuhiu, trajner i Dritës, ka thënë se kundërshtari ka një skuadër cilësore, por se skuadra e tij është përgatitur për t'i marrë tri pikët e plota

**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - FC Drita, pas barazimit ndaj Llapit në Gjilan, është përgatitur që t'u rikthehet fitoreve në një ndeshje mjaft të vështirë që e pret sot (e mërkurë) kundër Malishevës. Kjo ndeshje zhvillohet në stadiumin "Liman Gegaj" me fillim nga ora 13:00. Trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu, beson se skuadra e tij do të ketë paraqitje të përkryer dhe në fund do t'u gëzohet tri pikëve. "Unë kam besim që do të përformojmë në mënyrë të përkryer. Jemi të vetëdijshëm për forcën e skuadrës kundërshtare, pasi ajo ka një start të mirë dhe është përforcuar me futbollistë që e njohin kampionatin. Jemi

munduar që të përgatitim skuadrën tonë, të jemi vetvetja dhe të luajmë në mënyrën siç dimë ne. Ndeshja kërkon vlerësim, qasje të plotë dhe mendoj se do ta gjejmë mënyrën dhe veprimet e duhura të dalim nga kjo ndeshje shumë mirë", ka thënë Nuhiu. "Objektivi i Dritës është që të fitojmë këtë ndeshje. Objektivat e klubit i kemi deklaruar edhe më herët, por nuk jemi vetëm në garë dhe kemi kundërshtarë të cilët po përformojnë mirë. Është e rëndësishme t'i marrim ndeshjet një nga një, të marrim më të mirën, pastaj të presim rivalët dhe rezultatet e të tjerëve", ka deklaruar Nuhiu. Ndërsa futbollisti Albin Krasniqi ka deklaruar: "KF Malisheva ka lojtarë me eksperiencë dhe që dinë të



bëjnë diferencën në lojë. Kemi bërë të gjitha përgatitjet dhe shpresoj të jemi në ditën tonë më të mirë. I kemi analizuar futbollistët e saj dhe në përgjithësi skuadrën për ta ndaluar".

Drita në këtë ndeshje do të jetë pa mbrojtësin Ilir Blakçori për shkak të një lëndimi, ndërsa kthehet Muharrem Jashari. Skuadra e Malishevës renditet në vendin e shtatë me 23 pikë,

kurse Llapi është në vendin e katërt me 33 pikë.

### Batatina: Ndaj çdo kundërshtari luajmë për fitore

Trajneri Tahir Batatina ka thënë se Llapi do t'i kërkojë tri pikët në stadiumin "Zahir Pajaziti" përballë Feronikelit. Skuadra nga Drenasi po luan me juniorë

në sezonin pranveror, por Batatina ka bërë me dije se djelmshat e tij ndaj çdo kundërshtari kërkojnë tri pikët. "Ne kemi një ndeshje me rëndësi para vetes dhe nuk ka rëndësi se me kë përballemi. Jemi të vetëdijshëm që ndeshja duhet të fitohet. Ndeshja fitohet vetëm në fushë dhe ne si skuadër kemi marrë të gjitha masat që pas ndeshjes së kaluar që kishim me Dritën, të përgatitemi sa më mirë për ndeshjen e nesërme me Feronikelin që të paraqitemi sa më mirë", ka thënë Batatina, i cili ka konfirmuar se në këtë ndeshje do të debutojë sulmuesi Latif Amadu.

#### SUPERLIGA - Java 21

**Të mërkurën takohen:**  
13:00 Malisheva - Drita  
13:00 Ballkani - Ulpiana  
13:00 Llapi - Feronikeli

**Të enjten takohen:**  
13:00 Gjilani - Dukagjini  
13:00 Drenica - Prishtina

## Giresse sot emërohet trajner i Kosovës

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Trajneri francez Alain Giresse të martën pasdite ka mbërritur në aeroportin e Prishtinës. Ai është pritur nga kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. Federata e Futbollit të Kosovës ka paralajmëruar një konferencë për medie të mërkurën në orën 13:00. Gazeta "Epoka e re" ka mësuar se zyrtarizimi i Giresse trajneri i "dardanëve" do të bëhet pikërisht në këtë konferencë. Sa ka qenë futbollist Giresse ka luajtur për skuadrat Bordeaux e Marseille dhe për Kombëtaren e Francës, ndërsa në detyrën e trajnerit ka drejtuar Toulouse (1996-98 dhe 1999/2000), Paris Saint-Germain (1998) dhe FAR Rabat



(2001/2003). Po ashtu, ka drejtuar Gjeorgjinë (2004/2005), Gabonin (2006/2010), Malin (2010/2012 dhe 2015/2017), Senegalin (2013/2015) dhe Tunizinë (2018/2019).

## Albina Rugova lëndohet rëndë, do të mungojë gjashtë muaj

**ISTOG, 22 SHKURT** - Hendbollistja e Përfaqësueses së Kosovës, Albina Rugova, ka pësuar lëndim serioz. Ajo është lënduar në ndeshjen e fundjavës në mes të Prishtinës dhe Istogut. Albina është kapitene e Istogut dhe një prej lojtareve kryesore të kësaj skuadre. Rugova është, po ashtu, lojtare e rëndësishme e Përfaqësueses së Kosovës. Paraqitet në pozitën e alos. "Albina Rugova ka këputur ligamentin e gjurit të djathtë dhe duhet t'i nënshtrohet operacionit. Ajo do të mungojë



reth gjashtë muaj në terrenet e hendbollit", thuhet në njoftimin e skuadrës së Istogut.


## Tensionet mes Rosisë dhe Ukrainës rrezikojnë finalen e Ligës së Kampionëve

Shën Petersburg, 22 shkurt - Kriza mes Rosisë dhe Ukrainës, që mund të eskalojë në luftë, mund të ketë ndikim edhe në botën e futbollit. Finalja e Ligës

së Kampionëve, e programuar të luhet në Shën Petersburg, është vënë në dyshim të madh. UEFA me anë të një njoftimi për shtyp ka mohuar një ndryshim

të vendit ku do të luhet finalja: "UEFA po përcjell situatën. Për momentin nuk ka asnjë plan për ta ndryshuar vendin e finales". Alternativat në Evropë

për ta luajtur finalen e kompeticionit më të rëndësishëm për klube, nëse konflikti do të përshkallëzohet, janë të shumta.





## Hamiltoni: Nuk e keni parë ende versionin tim më të mirë

Londër, 22 shkurt - Të mërkurën do të nisim në pistën e Barcelonës testet e para dimërore në Formula 1. Vëmendja është përqendruar te piloti britanik i Mercedesit, Lewis Hamilton. Pasi humbi titullin kampion në xhiron e fundit të sezonit të kaluar, ai

synon të hakmerret këtë vit, për ta korrur titullin e tetë në karrierë. "Gaboheni nëse mendoni se në këto vite keni parë në pistë versionin më të mirë të Lewis Hamiltonit. Prisni dhe do të më shihni këtë sezon", ka qenë deklarata e pilotit britanik, që provokon

rivalët e tij. Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit (FIA) ka nisur një hetim për atë që ndodhi në garën e fundit në Abu Dhabi. Vendimi i vetëm i marrë deri më tani është largimi i Michael Masit nga detyra e komisarit të garave.

"Unë pres që të shoh atë raport të FIA-s pas hetimit që do të bëjnë dhe shpresoj të jetë i drejtë. Shpresoj që ta lexojnë të gjithë, për ta kuptuar sa më mirë atë që ndodh dhe përse u morën ato vendime", ka thënë Hamiltoni.



## Hidhet shorti për Junior NBA Kosova

Prishtinë, 22 shkurt - Të martën ka filluar një projekt shumë i rëndësishëm për basketbollin e Kosovës, Junior NBA Kosova. Me një ceremoni zyrtare është hedhur shorti për Junior NBA Kosova. 30 shkolla fillore të gjeneratës 11-14 vjeç janë ndarë në dy konferenca, apo gjashtë divizione. Tetë më të mirat e Konferencës kualifikohen në "play-off" dhe më pas zhvillohet "Final Four", ku shpallet skuadra kampione. Hapjen e Draft Shortit e ka bërë kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu, i cili ka theksuar se ky është një projekt shumë me rëndësi për gjeneratat e reja, por edhe basketbollin e Kosovës, ndërsa shtoi se është i lumtur që edhe Kosova është pjesë e Ligës Junior NBA.

Zëvendësministria e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani, ka përshëndetur fillimin e këtij projekti, për të theksuar se janë të lumtur që e mbështesin, ashtu si shumë projekte të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Ish-basketbollisti i NBA-së, Jiri



Welsch, ambasador i Junor NBA, u është drejtuar të pranishmëve me rëndësinë që ka Junior NBA dhe sa është e dobishme për basketbollin, ku shumë lojtarë mund të dalin dhe të jenë kyçë për të ardhmen e basketbollit të Kosovës. Welsch nënvizoi se është shumë i kënaqur me mikpritjen që i është bërë dhe do të largohet me përshtypje shumë të mira për Kosovën. Adrian Carrion, përgjegjës i Junior NBA

Kosova, shtoi se për këtë projekt kanë biseduar para më shumë se dy vjetëve me drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe tashmë gjithçka po finalizohet, duke besuar se do të jetë një projekt shumë i rëndësishëm dhe i frytshëm për Kosovën. Më pas është bërë hedhja e shortit, ku 30 shkolla fillore janë ndarë në divizione dhe konferenca, varësisht nga regjionet që janë.

## LeBron: Nuk ka rëndësi se ku, do ta mbyll karrierën duke luajtur me djalin tim



LOS ANXHELOS, 22 SHKURT - Këtë verë basketbolli i lakersave, LeBron James, do të jetë lojtar i lirë. Në orët e fundit është përfolur për një rikthim te skuadra e Cleveland Cavaliersit. Vetë "king James" nuk e mohan këtë gjë: "Nuk i kam mbyllur derën asnjë alternative për të ardhmen time. Nuk e di ende se çfarë do të rezervojë e ardhmja ime". Gjithsesi, ëndrra e vërtetë

për LeBronin është të luajë me djalin e tij Broony, në vitin e tretë të gjimnazit. Në vitin 2024 ai mund të zgjidhet në "draft", çka i jep mundësi të luajë në NBA. "E konfirmoj që vitin tim të fundit në karrierë do të luaj me djalin tim Broony. Ku? Nuk e di, kudo që të luajë ai. Do të bëj gjithçka për të luajtur një sezon me të. Nuk bëhet më fjalë për para", është shprehur James.

## Botafogo shpreh interesim për Cavanin

Skuadra braziliane Botafogo dëshiron ta transferojë sulmuesin e Manchester Unitedit, Edinson Cavani. Botafogo është klubi i ri brazilian i gatshëm për t'u bërë referenca më e madhe në futbollin e Amerikës së Jugut, duke pasur parasysh ardhjen e mundshme të disa yjeve që janë aktualisht në tokën evropiane. E ndër ata që janë në listën e Botafogos

është edhe sulmuesi uruguaiian i Manchester Unitedit. Botafogo dëshiron të formojë një skuadër plotësisht konkurruese pas rikthimit në elitën e futbollit brazilian. Cavanin i përfundon kontrata me Manchester Unitedin më 30 qershor, derisa deri më tash nuk ka pasur asnjë lëvizje nga klubi anglez për ta zgjatur marrëdhënien kontraktuale

me futbollistin 35-vjeçar. Por, Botafogo nuk është skuadra e vetme e Amerikës së Jugut e interesuar për nënshkrimin e Edinson Cavanit, pasi Boca Juniors, Atletico Mineiro dhe Corinthians gjithashtu kanë qenë së fundmi të interesuara për transferimin e "Matador"-it, i cili kohët e fundit është lidhur edhe me skuadrat më të mira evropiane si Barcelona apo Atletico Madrid.

### SHKURT

#### Liverpooli heq dorë nga transferimi i Mbappes

Skuadra e Liverpoolit nuk është në garë për transferimin e Kylian Mbappes. Fituesi i Kupës së Botës ka edhe disa muaj të mbetur në kontratë me PSG-në dhe me shumë gjasë do të largohet në verë si agjent i lirë. Real Madridi, gjithashtu, është konsideruar favorit për nënshkrimin me francezin, derisa shanset tashmë veçse janë shtuar. Liverpooli ka qenë i lidhur me 23-vjeçarin por, sipas "Sport", skuadra e Jurgen Kloppit nuk do të provojë ta transferojë në verë.

#### Aguero: Dua të luaj futboll, por jam i frikësuar

Sulmuesi Sergio Aguero ka pranuar se dëshiron të luajë futboll, por frikësohet se mund t'i përkeqësohet gjendja. Ish-sulmuesi u detyrua të pensionohet para kohe nga futbollin pas këshillave mjekësore nga mjekët e tij. Sipas "TYC Sports", Aguero deklaroi se dëshiron të luajë futboll, por frikësohet se mund t'i përkeqësohet gjendja. "Sot dua të luaj, por jam i frikësuar. Jam stërvitur gjatë gjithë jetës sime në maksimum dhe në gara të mëdha. Nuk shikoj futboll apo lajme, nuk më intereson çfarë është duke ndodhur. Unë përqendrohem në atë që më pëlqen më shumë, si miqtë. Rikthimi për të luajtur më vjen në kokë herë pas here, por e di që është diçka që nuk mund ta bëj. Më thanë se isha me fat sepse mund të kisha pasur lehtësisht një sulm në zemër. Tani është koha për t'u çlodhur. Jam i kënaqur me atë që po bëj", ka deklaruar Aguero. Aguero pas një lëndimi të rëndë që pësoi gjatë ndeshjes ndaj Alaves, u diagnostifikua me aritmi kardiake, si rezultat i kësaj ai u detyrua të tërhiqet nga futbollin para kohe.

#### Aubameyang: Të luash për Barçën është mundësi që të vjen një herë në jetë

Pierre Emerick-Aubameyang ka pranuar se ka hequr dorë nga paga prej mbi 400 mijë eurosh në javë për t'iu bashkuar Barcelonës. 32-vjeçari ishte ndëshkuar nga Mikel Arteta dhe iu hoq shiriti i kapitenit për mungesë disiplinë. Një muaj më pas ai u largua nga Arsenalin me marrëveshje të dyanshme dhe iu bashkua Barcelonës në ditën e fundit të afatit kalimtar të janarit. "Unë dëshiroja të vija te Barcelona. Hoqa dorë nga paga sepse është mundësi që të vjen një herë në jetë", ka deklaruar sulmuesi nga Gaboni.

#### Pele vazhdon mjekimin në spital

Legjenda e futbollit brazilian, Pele, ka një infeksion urinar dhe do të mbahet në spital për më shumë se sa kishin planifikuar mjekët. 81-vjeçari, i cili i është nënshtruar kimioterapisë për një tumor të zorrës së trashë që u hoq në shtator, u kthye në spitalin "Albert Einstein" më 13 shkurt. "Megjithatë, gjatë qëndrimit të tij u kryen ekzaminime rutinë që treguan praninë e një infeksioni urinar, një fakt që zgjat qëndrimin e tij si pacient në spital", raportohet nga mediet braziliane. Sipas një raporti nga ESPN, Pele iu nënshtrua një endoskopie javën e kaluar që e dobësoi dhe ka vështirësi në të ngrënë dhe të folur. Pele ka bërë kimioterapi për ta trajtuar tumorin që u gjet gjatë ekzaminimeve rutinë në fund të gushtit. Ai u vendos për një kohë të shkurtër në kujdes intensiv menjëherë pas operacionit në zorrën e trashë dhe që atëherë është rikuperuar.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada-Government*

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR  
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA  
ODRASLE

AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:130/1

Dt:22.02.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## RI-SHPALLJE E KONKURISIT

**Për plotësimin e vendit të punës në Qendra e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2021/2022**

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) Roje (40 orë pune në javë)	Zëvendësim

### Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore:

- Bënë roje të objektit sipas karakteristikave të përcaktuara;
  - Siguron objektin e Shkollës sipas kërkesave;
  - Monitoron lëvizjen e personave brenda hapësirës së Shkollës;
  - Me përgjegjësi të plotë i kryen detyrat e përcaktuara me një aneks kontratë në marrëveshje me të gjithë punëtorët roje;
  - Monitoron procesin përmes sistemit të kamerave dhe sistemeve tjera të sigurisë;
  - Bashkëpunon ngushtë dhe i përgjigjet personit të caktuar për sigurim të objektit të Shkollës si dhe organet tjera;
- Sipas nevojave të shkollës punëtori do të marrë detyra të reja në pozita tjera.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Kandidati duhet të ketë Shkollën e mesme,
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti,
- Kërkohej njohja e punës me kompjuter sistemi i kamerave,
- Kërkohej të ketë trajnime ose certifikata për roje dhe sigurim fizik të objekteve

### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

### FTESË PËR OFERTË

**Lloji i Kontratës:**  Furnizim  Shërbime  Punë

Nr. i Prokurimit: **02-22**

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:

Dosja për: **Kontrat për furnizim me faksimil**

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

### Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **07.03.2022 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **09.03.2022 ora 12:00.**

Ilapja e ofertave bëhet me datën: **09.03.2022 ora 14:00.**

Duke u bazuar në Nenin 57 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, operatori i kompanisë "BTP Holding" Sh.p.k. Vushtrri, fabrikë për riciklimin e vajrave e yndyrave ushqimore dhe naftës mbeturinë, Banjë, Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për dhënie e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 15.04.2022 në ora: 13.00, në hapësirat e REST. BTP HOLDING ne adresën Deshmoret e Kombit, Komuna e Vushtrrisë, do të organizohet debat publik nga operatori i kompanisë "BTP Holding" Sh.p.k. Vushtrri, fabrikë për riciklimin e vajrave e yndyrave ushqimore dhe naftës mbeturinë, Banjë, Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për aplikacionin për dhënie e Lejes Mjedisore të Integruar.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## PROTESTË!

*Proteston, refuzon, mallkon, pena e shkrimtarit:  
Kur burgosen çlirimtarët, burgoset edhe  
populli!  
Kur burgoset UÇK-ja, burgoset edhe liria!*



"Hero në luftë, Hero në paqe" – 1



"Drenica para gjyqit" – 2



"UÇK-ja para gjyqit" – 3



"Na e ban hallall, Kosove" – 4

"Edhe malet janë Kosova para gjyqit,  
UÇK - 5"Murtaja e Kuqe-7  
dramë, 6

(Këta janë 7 libra publicistikë, të botuar nga Riza Greiçevci për Gjykatën Speciale të Hagës, ku po gjykohen: UÇK-ja, çlirimtarët, Drenica, liria, dëshmorët, pushka e Adem Jasharit, Kosova...!)



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

## RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- ▶ Berat Plava nga Gjakova, shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X, XI, XII të Gjymnazit "Hajdar Dushi".
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m<sup>2</sup>, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m<sup>2</sup> dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m<sup>2</sup>, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




**MEKA**  
HALAL FOOD

# PASHTETË PULE

gluten free



100% mish pule



*cilësi e garantuar*

pa konservues